



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2021:050971

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500197

C.nr.251/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.L nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.R.M, nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 25.03.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**  
(pa shqyrtim gjyqësor)

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditëses Sh.L nga Vushtrria ashtu qe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses Sh.L nga Vushtrri në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta) për ditët e pranisë në punë gjatë periudhës kohore (224 ditë të pranisë në punë) prej 03.11.2019 e gjerë me datën 15.02.2021 të i'a paguaj shumen prej 448 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 18.03.2021 e gjerë në në pagesën definitive të detyrimeve si dhe shpenzimet e procedure kontestimore në lartësi të përgjithshme prej 125.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

Paditësja Sh.S nga Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.R.M nga Vushtrria, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 18.03.2021, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj shpenzimet e shujtave (ushqimit) gjate ditëve të punës kundër te paditurës Komuna e Vushtrrisë, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe atë të vitit 2021 me arsyetimin se të njëjta i takojnë ndërsa e paditura nuk ia ka kompenzuar.

Gjykata me aktvendimin C.nr.251/21 të datës 26.02.2024, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 12.03.2024.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditëseve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësit e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 18.03.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëseve ta hedhë poshtë si të palejuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimi i lëshuara nga ShF "A..." në Vushtrri, e datës 15.03.2021 për Sh.L kontestuese nuk ishte prania e paditëses në punë si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë

Kontestues ishte parashkrimi i kërkesës së paditëseve mirëpo edhe ky pretendim i të paditues është i pa bazuar pasi që paditësja kërkesen e saj e ka paraqitur brenda afatit ligjor me Ligjin e Punës.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *"kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë"*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *"kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *"Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore"*, si dhe vërtetimit të lëshuar me datën 15.03.2021 nga Shkolla Filllore "A..." në Vushtrri për paditësen Sh.L për periudhën nga datë 03.11.2019 e deri më datë 15.03.2021, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është bazuar, andaj edhe ia njohu shumën prej 448 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2.00 euro (224 ditë pune x 2 euro =448.00 euro).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"*, ndërsa paditësja kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 03.11.2019 deri më 15.03.2021, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 18.03.2021.

Gjithashtu vlen të theksohet se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 në nenin 45 të saj ka paraparë se Kontrata Kolektive do të zbatohet edhe për një vit tjetër nëse palët nuk tërhiqen nga e njëjta ndërsa gjykata nuk ka prova se nga e njëjta janë terheqë ndonjë palë kontraktuese.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke ia njohur paditëses shumën prej 125 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 21 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro.

Numri i lëndës: 2021:050971  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05500197

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil  
C.nr.251/21, datë: 25.03.2024

Gj y q t a r i  
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në prishtinë, në kopje të mjaftueshme.